



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:256874

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05601728

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të D.M., nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II nr.31/23 të datës 23.11.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **19.04. 2024**, në prani të Prokurorit të shtetit Kastriot Memaj si dhe të akuzuarit D.M., me datën 22.04.2024, morri dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **D.M.**, i lindur me datë ... në ..., me vendbanim në Rr.”..... “, Komuna Gjakovë, nga i ati ... dhe e ëma ... e vajzërisë B., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal.... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:**

-Me datë 31.07.2022 rreth orës 04:40 minuta në fshatin ..K-Gjakovë, pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit marihuanë me peshë 0.55 gram, në atë mënyrë që derisa i pandehuri ishte duke drejtuar veturën e tipit BMW me targa 07-311-DO, është ndaluar nga policia pasi që kishte bërë vozitje të rrezikshme dhe me rastin e kontrollimit tek i pandehuri në xhepin e majtë të përparmë të pantallonave i’u është gjetur narkotiku i llojit marihuanë, e cila është sekuestruar nga policia . ,

**-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar narkotikëve ,substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2- 1 të KPRK-së.**

**Gjykata në kuptim të neneve 4, 7,17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 44,69, 70, 71 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.3 , dhe nenit 269 par.2-1të KPRK-së , si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e gjykon :**

## DËNIM ME GJOBË

Dënim gjobë në shumë prej **300 (treqind )euro** ,të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë ) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej 20.00 si dhe në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30.00 €, në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**Bazuar ne nenin 269 par.3 të KPRK-ës, :**

**Konfiskohet** substanca narkotike e llojit marihuarnë me peshë neto: 0.55 +\_0.0001gram, e cila është sekuestruar me dt. 31.07.2023

### A r s y e t i m

#### 1.Ecurija e procedurës penale

Prokuroria Themelore-Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën PP/II nr.31/23 të datës 23.11..2023 , për te akuzuarin D.M., për shkak të veprës penale ke kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve ,substancave psikotrope nga neni 269/1 të KPRK-ës .

Gjykata konstaton se me aktvendimin 2023:256874 te dt. 17.04.2024 , ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qenë se i akuzuari D.M., nuk ka marr pjesë ne seancat e caktuar për te cilin është dashur te shoqërohet me detyrim nga st. Policor ne Gjakovë ,por sipas zy. policor H.GJ., ,me nr ref. 04/1-08-GJ-S-108/24 te dt. 17.04.2024.,jemi njoftuar se i njëjti është kërkuar ne shtëpi por nuk është gjetur, numrat e telefonit ne adres nuk kanë funksionuar, nuk është përgjigjur edhe pse shtëpia ka qenë e hapur .andaj për te njëjtin ka lëshuar edhe urdhër arrest.

D.M , është paraqitur nga st. Policor lidhur me urdhër arrestin e lëshuar nga ana e kësaj gjykate ,dhe i njëjti është paraqitur në gjykate sot me dt. 19.04.2024, i njëjti do të procedohet dhe gjykata benë tërheqja e urdhër arrestit.

Në bazë te nenit 241 par.3. të KPPK-ës, prokurori i shtetit e lexon aktakuzën PP/II nr. 31/23 të dt.23.11.2023 dhe deklaroi me qenë se sipas evidencës penale për te akuzuarin D.M., rezulton se nuk gjendet ne evidencën e personave te dënuar , bëjë përmirësimin e dispozitivit te aktakuzës , me ç ‘rast duhet te jetë me çka ke kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve ,substancave psikotrope nga neni 269/2-1 e jo neni 269/1 te KPRK-ës siç është në aktakuzën e lartcekur .

I akuzuari D.M., , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 19.04.2024 , duke u deklaruar lidhur me fajësinë e , thekson e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti

lidhur me fajësinë deklaroi: se ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem sipas aktakuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, shtoj se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, kërkim falje publike në gjykatë, gjendjen e dobët ekonomike, të me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuari pasi që ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimit të tillë, pranim është bërë pas sqarimit të mjaftueshëm nga ana e gjykatës, po ashtu faktin se pranim i fajësisë mbështet në faktet e çështjes, respektivisht provave materiale dhe personale që përmban aktakuza. Lidhur me vendimin për dënim i propozon gjyqtarës që si rrethana lehtësuese të merret pranimin e fajësisë për veprën penale me të cilën akuzohet, ndërsa si rrethana rënduese dashjen në kryerjen e veprës penale.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari D.M.,, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas sqarimit të mjaftueshëm edhe nga gjykata, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :-

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D.M., : -Me datë 31.07.2022 rreth orës 04:40 minuta në fshatin Bec K-Gjakovë, pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit marihuanë me peshë 0.55 gram, në atë mënyrë që derisa i pandehuri ishte duke drejtuar veturën e tipit BMW me targa 07-311-DO, është ndaluar nga policia pasi që kishte bërë vozitje të rrezikshme dhe me rastin e kontrollimit tek i pandehuri në xhepin e majtë të përparmë të pantallonave i'u është gjetur narkotiku i llojit marihuanë, e cila është sekuestruar nga policia.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen: "Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet".

Ndërsa në par. 2. të këtij neni parashihet se “ *Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.*

3. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen.

#### 5. Vendimet e gjyqtarës së vetme gjykuese

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, Gjatë pranimi të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin D.M., nga Gjakova , e ka shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tije.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin konstaton faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, peshën e veprës penale, dashjen e kryerjes së veprës penale ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se njëjti është i moshës relativisht të re, i pa punë . Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, sjelljen tejet korrekte në gjykatë , kërkim falja publike, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet si dhe fakti se nga se Evidenca penale PDP për të akuzuarin, nuk ka të kaluar kriminale , aktvendim apo aktgjykim të formës së prerë dhe pas këtij rasti është inicuar ndonjë rast tjetër të cilat rrethana ndikuan që gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në nenin 70 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi , me bindje se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit marihuanë me peshë : 0.55 +\_0.0001gram, që është objekt i kësaj vepre penale. , u murr komform nenit 269 par.3 të KPRK-ës .

7.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 449 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 3, nën.par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**2023:256874 me datën 22.04.2024**

**Sekretarja juridike**  
**Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.